

SUBJEKTI P.F “KASTRIOT BASHA”

**KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E
KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA
PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B**

“Menaxhimi i Mbetjeve”

ID 5.5 Magazinimi hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë material të rrezikshme me kapacitet të barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.

ID 5.8. magazinim, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave me kapacitet kufi për lejet e tipit B: të gjitha instalimet.

“ Industritë prodhuesetë makinerivedhe pajisjeve”

ID 10.4 Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s.nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë me kapacitete barabartë me 5 ura ose më shumë se kaq.

SUBJEKTI: P.F “KASTRIOT BASHA”

ADMINISTRATORI: Z. KASTRIOT BASHA

**VENDNDODHJA: LEZHE LAC LAGJJA NR 5, RRUGA E
KOMBINATIT, NDERTESE 1 KATESHE, ZK. NR.1768, ME
PASURI NR.132/102, 132/100**

SUBJEKTI “KASTRIOT BASHA” ME PERFAQESUES LIGJOR Z. KASTRIOT BASHA MERRET ME AKTIVITETIN:

“MENAXHIMI I MBETJEVE” ID 5.5 Magazinimi hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë material të rrezikshme me kapacitet të barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.

ID 5.8. magazinim, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave me kapacitet kufi për lejet e tipit B: të gjitha instalimet. “Industritë prodhuesetë makinerive dhe pajisjeve” ID 10.4 Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s.nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë me kapacitete barabartë me 5 ura ose më shumë se kaq.

Subjekti “Kastriot Basha” me NUIS: K37810313M dhe me vendndodhje: Lezhe Lac lagjja nr 5, rruga e kombinatit, ndertese 1 kateshe, zk. nr.1768, me pasuri nr.132/102, 132/100

Trualli në të cilin ndodhet objekti, shtrihet në një terren të rrafshët ndërsa prona është e karakterizuar nga një sipërfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk është i ndjeshëm. Në këtë proces nuk ka përdorim uji.

Procesi i demontimit të mjeteve pasi makinat për çmontim grumbullohen në sheshin e vendosur jashtë veprimtarisë, ato çmontohen pjesë për pjesë duke grumbulluar llamarinat e makinave dhe duke i ndarë nga pjesët metalike, nga motorët jashtë përdorimit, nga gomat dhe nga pjesët e tjera të papërdorshme të makinave. Makinat për demontim vijnë në subjekt, grumbullohen në sheshin para aktivitetit dhe me pas i nënshtrohen procesit të demontimit pjesë për pjesë. Ambienti për çmontimin e mbetjeve nga motorët e makinave është vendi ku kryhen proceset për çmontimin e pjesëve të makinave të dalta jashtë përdorimit, me qëllim riciklimin e tyre si pjesë këmbeje të përdorura. Pjesët çmontohen me ndihmën e pajisjeve mekanike dhe i nënshtrohen procesit të kontrollit fizik të tyre, duke parë gjendjen funksionale për riciklimin e tyre. ato sistemojnë në raftet e montuara brenda objektit sipas tipit dhe markes së mjeteve, me qëllim për tu ricikluar.

Operimi

Për sa i përket mënyrës së funksionimit të aktivitetit është një praktikë shumë e thjeshtë e cila ndihmon në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Regjimi i punës në aktivitetin në fjalë kryhet vetëm me një 1 turn, e cila konsiston në disa hapa fare të thjeshtë. Hapat e punës nga hyrja e ngarkesës deri në dalje janë si më poshtë:

1. Mberitja e mbetjeve të skrapeve/hekurishteve dhe mbetjeve të makinave në vendndodhje
2. Shoqërimi i ngarkesës nga personi përgjegjës drejt peshores
3. Kontrolli vizual i ngarkesës nga personi përgjegjës për natyrën e metaleve
4. Peshimi i ngarkesës
5. Depozitimi i ngarkesës në sheshin para seleksionimit
6. Diferencimi dhe depozitimi në ambientin e destinuar për mbetjet e seleksionuara.

7. Shitja ne tregun vendas apo te huaj.

Pasi ngarkesa vjen ne ambientin e aktivitetit, shoqerohet nga personi pergjegjes drejt peshores. Perpara peshimit personi i cili shoqeron ngarkesen kryen inspektimin vizual per te pare nese eshte kategoria e mbetjeve qe pranohen ne aktivitet apo jo. Pas kesaj faze ngarkesa shkon drejt peshores e cila kryhen peshimin e saj. Personi pergjegjes ne regjistrin mban rekorde per sasine, llojin, dokument i nenshkruar nga dorezuesi dhe marresi. Pas kesaj faze mbetjet e metalit depozitohen ne sheshin e depozitimit para seleksionimit. Mbasi kryhet seleksionimi i tyre ato depozitohen ne vendin e percaktuar pas seleksionimit. Pas kalimit te te gjithë hallkave matalet e diferencuar shiten ne kompani te licensuara, te cilat dergohen/terhiqen duke respektuar legjislacionin aktual mbi transportimin e mbetjeve.

Disa nga proceset qe ndodhin jane:

Heqja e baterise se makines, dinamos dhe komponenteve elektrik te sistemit te tyre.

Cdo pjese magazinohet ne sektorin e saj dhe kalon per shitje. subjekti ka lidhur kontrate me kompani te licencuar per grumbullim, transportim dhe ruajtje te baterive

Heqja e gomave, dhe ne rastet me te medha te subjektit vijne pa goma, ai merr dhe rishet vetem disqet. Heqja e pjeseve te medha plastike si (parakolpit dhe prapakolpit).

Cdo pjese magazinohet ne sektorin e saj dhe kalon per shitje tek individe ose biznese te tjera pjesesh kembimi, servise etj.

Çmontimi i pjeseve metalike, llamarinave dhe mbetjeve nga motoret e makinave.

Vendndodhje





Teknologjia është e thjeshtë dhe tradicionale por gjithsesi duke përdorur makineri të kohës dhe cilësore. mbetjet riciklohen ose grumbullohen në një pikë të caktuar dhe dërgohen në vendin e caktuar nga bashkia dhe pjesa tjetër terhiqen nga operatorë të licencuar. Territori dhe ambienti brenda dhe jashtë është gjithmone i pastër, i sistemuar duke mbjellë bimë dekorative. Mirembahet me kujdes rrjeti i brendshëm i furnizimit me ujë dhe energji elektrike si dhe sistemi kullues i ujerave. Respektohen rigorozisht rregullat higjieno sanitare dhe të sigurimit teknik të punonjësve të subjektit dhe të mos ushtrohet asnjë ndikim negativ në shëndetin e popullatës.

Duhet theksuar që subjekti ka kohë që e ushtron këto aktivitete në këto ambiente dhe nuk ka patur probleme me komunitetin dhe sipërmarresit e zonës. Trualli në të cilin ndodhet objekti, shtrihet në një terren të rrafshët ndërsa prona është e karakterizuar nga një sipërfaqe uniforme ku efekti i erozionit në territorin e zgjedhur është i pershtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti duke paraqitur disa përparesi si:

- Sistem perspektiv të furnizimit me ujë
- Sistem perspektiv të furnizimit me energji elektrike.
- Mundësi për zbatimin korrekt të projektit
- Mundësi për ngritje të sistemit të kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni i sheshit ka të zgjidhura disa nga problemet që lidhen me anën funksionale si:

- largësi të mjaftueshme nga vendet e banuara.
- pranë fuqisë punëtore.

BAZA LIGJORE

- ❖ Ligji nr 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- ❖ Ligji nr 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe ndryshimet e tij.
- ❖ Ligji nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit
- ❖ Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotur”
- ❖ Ligji nr. 9537, datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”
- ❖ Ligji 9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- ❖ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- ❖ VKM nr. 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”
- ❖ VKM nr. 402, datë 30.6.2021 “për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”

- ❖ VKM nr.435,date.12.09.2002“per normat e shkarkimeve ne ajer ne republiken e shqiperise”
- ❖ VKM nr.103, date. 31.03.2003 “Per monitorimin e mjedisit ne republiken e shqiperise”
- ❖ VKM 435, date 12/09/2002 "Per miratimin e normave te shkarkimit ne republiken e shqiperise".
- ❖ Udhezimi nr.2,date 15.11.2023 “Per nivelin kufi te zhurmes per nje mjedis te dhene dhe per fushen e veprimtarive ekonomiko-shoqerore”
- ❖ VKM 177, date 31/03/2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese".
- ❖ Ligji nr. 10 433, date 16.06.2011 “ Per inspektimin ne republiken e shqiperise”
- ❖ Ligji nr. 10279 , date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative”
- ❖ Ligji nr. 9824, date 1.11.2007 “Per akreditimin e organizmave te vlersimit te konformitetit ne Republikën e Shqipërisë”

Ndikimet në mjedis ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme. - nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. niveli i zhurmes nuk i kalon 55db(a) gjate punes. ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.

- fenomene të tjera. vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- trafiku gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.

- projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. zbatimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B subjekti ka siguruar zbatimin e masave që parandalojnë ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normen e lejuar për ajrin, për ujën dhe për token, pakesimin dhe riperdorimin e mbetjeve që gjeneron veprimtaria si dhe respektimin e kërkesave dhe të kushteve të lejes mjedisore.

Subjekti gjatë kryerjes së këtij aktiviteti lag dhe sperkat mjedisin përreth një deri dy here në ditë për të reduktuar çlirimet e pluhurave.

Furnizimi me lende të pare dhe transporti bëhet në orët me trafik të pakesuar. subjekti ka marrë masa për lagjen e here pas hershme të ambienteve me qëllim mos ngritjen e pluhurave.

Për sa i përket ruajtjes dhe magazinimit të lendeve të para janë vënë në dispozicion ambiente të veçuara dhe të përshtatshme. Është kryer pajisja e subjektit me sinjalistikën e duhur me qëllim shmangien e aksidenteve njëzore. Janë zbatuar të gjitha normat ligjore për shkarkimet në toke, uje dhe ajër.

Janë marrë masa për parandalimin e rënies të zjarrit dhe janë siguruar mjetet e nderhyrjes në rast të rënies së zjarrit ky aktivitet i kushton rëndësi të vecantë mbrojtjes së mjedisit dhe në rast ndotje brenda apo jashtë objektit do të merren masa që të pastrohen menjëherë. Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive bëhet brenda sipërfaqes së objektit. Transporti i materialeve është bërë me mjete të pastra nga balta dhe të mbuluara. Është menjanuar rënia e borive të automjeteve nga shoferët për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banorët. Makineritë janë mirëmbajtur teknikisht. ato janë përdorur me efikasitet duke minimizuar kohën gjatë së cilës mbahen ndezur motorët. Sherbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmese bëhet në ambiente të vecanta të tilla që evitojnë ndotjen e mjedisit nga ky proces. Subjekti ka zbatuar kërkesat e lejes mjedisore si dhe normat e standardet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin nga ndikimet negative të veprimtarisë. pastrohen menjëherë rrjedhjet, derdhjet, pikimet që mund të shkaktojnë automjetet gjatë transportit ,për të parandaluar ndotjen e tokës. Respektohen standardet e normativat për nivelin e zhurmave të lejuar sipas standartit të BE-së.

Konkluzione në materialin e mësipërm shihet se ka një ndikim minimal, por gjithsesi është i ndërgjegjshëm se sado minimal ky ndikim duhet të mirë-menaxhohet dhe të bëhen përpjekje teknike për të bërë këtë ndikim me vlerë zero. Aktiviteti konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm në zonën e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore për zonën përreth. Subjekti P.F“Kastriot Basha” do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë cdo sygjërim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone. aktiviteti jone në përputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një

subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja , Ky subjekt duhet te aplikojë për leje mjedisi të tipit B dhe konform te te gjitha akteve dhe procedurave ligjore ne fuqi i drejtohem AKM-se për ndjekjen e procedurës konsultimit me publikun dhe palet e interesuara për aplikimin për leje mjedisi të tipit B: “Menaxhimi i Mbetjeve” “ID 5.5 Magazinimi hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë material të rrezikshme me kapacitet të barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq. ID 5.8. magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave me kapacitet kufi për lejet e tipit B: të gjitha instalimet. “ Industrinë prodhuesetë makinerive dhe pajisjeve” ID 10.4 Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s.nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë me kapacitete barabartë me 5 ura ose më shumë se kaq.

Te merren masa për të eliminuar ndonjë ndotje aksidentale gjatë punës në rast se ato shfaqen nga pakujdesi njerëzore. Te njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat higjieno sanitare që duhen zbatuar gjatë procesit të punës. të largohen të gjitha mbetjet e ngurta që krijohen si rezultat i punës dhe aktivitetit (nese ka). Për sa me sipër subjekti P.F “Kastriot Basha” e ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ka investuar për përmirësimin e mjedisit dhe mirëpret çdo sygjërim në të mirë të cilësise së punës.

Inxhinier mjedisi
Ing M.Sc Ina Bora

